



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 71-të të mbajtur më 30.06.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2134/1, datë 10.06.2021, me pretendime për parregullsi në procedurë gjyqësore, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent duke marrë parasysh se pretendimet i referohen organit tjetër kompetent për të vepruar.

Lënda me numër 12-2134/1 të datës 10.06.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Më 10 qershor 2021, nga një parashtrues i njohur është dorëzuar denoncim me pretendime për parregullsi në procedurat gjyqësore dhe është formuar lënda me numër 12-2134/1, datë 10 qershor 2021.

Në denoncim theksohet se ----- si njëra nga palët në procedurë gjyqësore më 24.03.2021 është dorëzuar shkresë në ----- me të cilën kërkon nga fakulteti që të dorëzohet dëshmi për lëndën që zhvillohet duke konsideruar se provat kanë humbur. Parashtruesi thekson se i janë drejtuar gjykatave më të larta me kërkesë për të përcaktuar lëvizjen e çështjes, si dhe kanë njoftuar Këshillin Gjyqësor të RMV-së. Sipas denoncimit, ----- ka vepruar sipas kërkesës së tyre, duke i njoftuar për rrjedhën e procedurës që është zhvilluar pranë kësaj gjykate dhe në denoncimin e dorëzuar në këto mënyrë nuk është konstatuar se gjyqtari i cili e ka referuar lëndën dhe atë brenda një dite pas caktimit në punë, ka njoftuar këshillin e gjyqtarëve që vepron në auditim se mungojnë dokumentet dhe provat. Disa nga këta gjyqtarë nuk kanë deklaruar para komisionit të ngritur për të përcaktuar lëvizjen e çështjes për shkak të sëmundjes dhe shkarkimit nga posti gjyqësor. Njëri nga gjyqtarët nuk e ka nënshkruar vendimin me arsyetimin se në shkresat e lëndës mungonte

padia dhe lenda është kthyer në dosje dhe gjyqtari nuk ka deklaruar para komisionit për shkak të daljes në pension. Rasti ka qenë në zyrën e gjendjes civile për dy muaj të tërë pa dokumente dhe prova.

parashtruesi kërkon nga KSHPK që të përfshihet në procedurë për të sqaruar situatën me rastin, si dhe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve si gjyqtari që e ka referuar lëndën në ----- e ka studiuar brenda një dite dhe i referohet një mosmarrëveshjeje që ka 18 vjet, pastaj për të përcaktuar se kur dhe si kanë humbur provat dhe kush do të jetë përgjegjës për vazhdimin e procedurës me dokumentet e humbura.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë dhe dokumentacionit të paraqitur në bashkëlidhje, KSHPK-ja vlerësoi se pretendimet i referohen trajtimit të një çështjeje të caktuar nga gjyqtarët e ----- Gjykatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilat pretendime, kompetente për të vepruar është Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me kompetencën e tyre të përcaktuar në nenin 36 paragrafi 1 paragrafi 15 dhe 16 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së për të vepruar në peticionet dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe tribunaleve dhe të kujdeset për reputacionin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë.

Nga sa u tha më lartë dhe duke pasur parasysh se parashtruesi në denoncim thekson se e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të RMV-së, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprim kompetent, pas së cilës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami